



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
FAKULTETI EKONOMIK
DEPARTAMENTI I SË DREJTËS**

PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT TREGTAR SHQIPTAR NË BASHKIMIN EUROPIAN

Temë Diplome

Diploma: Bachelor në Shkenca Juridike në sektorin publik

Punoi:

Eranda TOPALLI

Udhëheqës Shkencor:

Prof.As.Dr.Arbër GJETA

ELBASAN 27 SHTATOR 2022

© **Copyright** Eranda Topalli, Viti 2022

Përmbajtja e këtij punimi është totalisht autentike. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

DEKLARATË

Unë e nënshkuara Eranda Topalli deklaroj që:

- Kjo temë diplome përfaqëson punimin tim origjinal, përveç rasteve të citimeve dhe referencave.
- Kjo temë diplome nuk është përdorur më parë si temë diplome apo detyrë kursi në këtë universitet apo në universitetet e tjera bazuar në kërkimet e mia teknologjike.

Eranda Topalli

Si udhëheqës shkencor e këtij punimi deklaroj se e kam ndjekur dhe ai nuk është një plagjiaturë. Diplomanti gjatë ecures së punimit të tij ka ruajtur konfidencialitetin dhe ka ecur në bazë të çështjeve etike duke i respektuar ato.

Punimi nga ana ime vlerësohet për punën e kryer dhe risinë që ka sjellë.

Prof.As.Dr. Arbër Gjeta

Data 27 Shtator 2022



ABSTRAKT

Rëndësia e integritit të shtetit tonë drejt standardeve Evropiane ka qenë prej vitesh në fokusin tonë. Nisur drejt këtyre standardeve dhe përpjekjeve tona për ndërkombëtarizim dhe një treg me qiell të përbashkët, fitorja jonë e parë ishte ajo e nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit. Një arritje jo vetëm në legjislacionin e shoqërive tregtare, por një arritje e përgjithshme. pas këtij hapi nisën dhe përmirësimet bazuar në rregulloret dhe direktivat e KE. Shoqëritë tregtare dhe organizatat e biznesit në Shqipëri që prej vitit 2008 rregullohen nga ligji nr.9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Ku më pas janë bërë edhe ndryshimet e nevojshme ndër vite, për ta sjellë këtë ligj drejt përmirësimit edhe përafritit të legjislacionit të Bashkimit Evropian. Në këtë punim paraqitet një këndvështrim i ecurisë së hapave dhe ecurisë së zhvillimit që ka pasur legjislacioni tregtar në Shqipëri ndër vite. Kjo duke pasur gjithmonë primare afrimitetin dhe integrimin e tij me Bashkimin Evropian. E së fundmi, por jo me më pak rëndësi ku gjendet situata e Shqipërisë sot përse i përket botës tregtare. Ky punim përmban një parashtrim të të gjitha arritjeve që ne kemi bërë drejt fokusit që kemi, por edhe problematikat dhe mangësitë që ende i kemi të dukshme në aspektin e legjislacionit tregtar duke mos qenë në nivelin e duhur për anëtarësim. Qëllimi i këtij punimi nuk është vendosja në dukje e mangësive që kemi ne si vend përse i përket përafritit të legjislacionit tregtar, por përmirësimi i këtyre çështjeve ku legjislacioni Evropian ende nuk ka dhënë ndikimin e duhur.



FALENDERIME

Finalizimi i këtij trevjeçari për mua ka qenë një arritje synimesh dhe një hap më shumë drejt formimit profesional. Këtë arritje ia dedikoj familjes sime dhe miqve të mi më të afërt, të cilët kanë qenë mbështetja ime më e madhe, sigurisht edhe stafit pedagogjik të “Fakultetit Ekonomik” pasi të lësh pas bangat e gjimnazit e të hapësh një derë e cila është krejtësisht e re për ty, veç fokusit kërkon edhe njerëz të kualifikuar të cilët ndajnë dijen e tyre. Prandaj në përfundim të këtij rrugëtimi u jam pafundësisht falenderuese të gjithëve sidomos departamentit të së drejtës për këtë formim dhe bagazh juridik. Një falenderim i veçantë shkon për udhëheqësin tim të diplomës, Prof.As.Dr. Arbër Gjeta, i cili më ka ndihmuar të finalizoj këtë punim.



PËRMBAJTJA E PUNIMIT

Hyrje.....	8
Pyetje dhe qëllimi i punimit	9
Metodologjia.....	10
1. Historiku dhe marrëveshja Stabilizim Asocimit	
1.1 Historiku i Ligjit për Shoqëritë Tregtare në Shqipëri.....	11
1.2 Angazhimi në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit.....	12
2. Legjislacioni për Shoqëritë Tregtare	
2.1 Legjislacioni për Shoqëritë Tregtare.....	15
2.2 Përmirësime të sjella në tregun e shoqërive tregtare.....	17
2.3 Rregullat e përcaktuara në raport financiar, kontabilist dhe Auditim.....	19
3. Përgatitja e Shqipërisë për Anëtarësim	
3.1 Përgatitja e Shqipërisë për anëtarësim në fushën e së drejtës për Shoqëritë Tregtare....	21
3.2 Përafrimi i legjislacionit në fushën e Kontabilitetit	24
3.3 Përafrimi i legjislacionit në fushën e Auditimit.....	27
Përfundime dhe rekomandime.....	31
Referenca.....	33



LISTA E SHKURTIMEVE

MSA- Marrëveshje e Stabilizim Asocimit

BE- Bashkimi Evropian

QKR- Qendra Kombëtare e Regjistrimit

QKB-Qendra Kombëtare e Biznesit

LSHT-Ligji për Shoqëritë Tregtare.

GJED-Gjykata Evropiane e Drejtësisë

SNA-Standardet Ndërkombëtare për Auditim

KE-Këshilli Evropian

NJIP-Njësi të Interesit Publik

OKB-Orgанизata e Kombeve të Bashkuara

AKSHI-Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së informacionit

SNRF-Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

KKK-Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit

IASB-Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit

MFE-Ministria e Financave dhe Ekonomisë

SKK-Standardet Kombëtare të Kontabilitetit

BMP-Bordi i Mbikqyrjes Publike

FATF- Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar



KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

HYRJE

Ligji jonë për Shoqëritë Tregtare ashtu si shumë nisma të tjera legjislative në përmbushje të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, që është objektivi i përgjithshëm i Shqipërisë për antarësim në Bashkimin Evropian , është bazuar në të drejtën evropiane *acquiscommunautaire* . Rrjedhimisht edhe ligji ynë nuk ka frymë të vetën përpos asaj të normave tashmë të konsoliduara në të drejtën *acquis*. Synimi i ligjit për shoqëritë tregtare ishte sanksionimi i një sistemi të thjeshtë, të qartë dhe të përditësuar, i aftë për të thithur investime të huaja dhe për të siguruar harmonizimin e dispozitave të tij me legjislacionin evropian të shoqërive tregtare. Rrjedhimisht, ligji për shoqëritë tregtare pasqyron standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare lidhur me të drejtën tregtare, drejtimin e brendshëm të shoqërive tregtare dhe përgjegjësinë sociale të tyre. Legjislacioni evropian ndryshon shpesh, dhe për rrjedhojë, legjislacioni shqiptar duhet të ndjekë ritmin e zhvillimeve të reja në nivel evropian.

E tërë esenca e punës mbështetet në të gjitha fazat në të cilat kalon ligji për shoqëritë tregtare. Që në fillimi kur kërkohej me domosdoshmëri nevoja e tij në sistemin legjislativ për të rregulluar problematikat e tregut, e më pas në përshtatjen e tij me standardet e kërkuara ose edhe të rekomanduara. Këtu filloi edhe procesi i ratifikimit të ligjeve dhe rregulloreve të cilat menjëherë pasi botohen në fletoren zyrtare kanë fuqi dhe duhet të mos jenë në kundërshtim me ligjin e brendshëm tregtar pasi në të tillë situatë fitojnë përparësi.

Sigurisht ky rrugëtim është pak i gjatë dhe kërkon angazhim jo vetëm të përafrimit të ligjit, por edhe fokusimit dhe mbikëqyrjes mbi regjistrimet e shoqërive tregtare apo paraqitjes së pasqyrave financiare. Kjo sepse *acquis* përcakton rregulla për paraqitjen e llogarive vjetore dhe të konsoliduara. Zbatimi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit është i detyrueshëm për disa subjekte të interesit publik. Për më tepër, *acquis* përcakton rregulla për miratimin, integritetin profesional dhe pavarësinë e auditimeve ligjore. Ligji për shoqëritë tregtare tashmë është vendosur në mënyrë të kënaqshme në një kontekst kombëtar të përafruar.



PYETJE DHE QËLLIMI I PUNIMIT

Ky punim në rradhë të parë ka si qëllim kryesor të bëj një pasqyrim të detajuar të Ligjit për shoqëritë tregtare. Miratimi i tij fillestar, rregullsia që ai solli në sistemin tonë ligjor e më pas duke treguar të gjitha hapat e ndërmarrë për të arritur në gjëndjen aktuale në të cilën ndodhemi sot. Sigurisht duke pasur në fokus situatën e shqipërisë dëshirën e saj për tu bërë pjesë e Bashkimit Evropian, por edhe nevojën e pashmangshme që ajo ka për tu përmirësuar dhe përshtatur. Metoda e cila është përdorur për të treguar ecurinë dhe përafrimin që ka pasur ligji për shoqëritë tregtare ndalur tek ndryshimet e pësura dhe direktivat e bëra pjesë të sistemit tonë.

Patjetër, interes mjaft të veçantë ka marrë Marrëveshja e Stabilizim Asocimit harmonizimi ligjor që kjo marrëveshje kërkonte. Kërkesat e saj të qarta dhe konkrete dhe fokusi i saj në tregun e brendshëm afrimi tij me standardet e kërkuara ishte element thelbësor. Më pas vijonin dhe elementët e tjerë ku ndër to edhe ai financiar.

Gjatë fillimit të këtij punimi ka mjaft pyetje, të cilat vlen të shtrohen, me nevojën e madhe për të marrë një përgjigje gjatë vijueshmërisë së detyrës. Fundja dhënia e përgjigjeve është ajo që na shtyn të informohemi drejt një teme të caktuar.

Pyetjet që shtrohen janë të qarta:

Sa ka arritur Shqipëria të çoj ligjin “Për shoqëritë tregtare” drejt standardeve të kërkuara?

A është angazhuar mjaftueshëm?

Ne vërtetë ndërmorëm hapa drejt përafrimit me legjislacionin e BE-së, por sa të sigurt ishin këto hapa?

Si kryhet mbikëqyrja e institucioneve financiare a ka transparencë të mjaftueshëm në rregullimin e ligjeve?

METODOLOGJIA

Puna studimore për këtë punimi ka kaluar në disa faza të cilat do ti shtroj më poshtë:

Në fazën e parë jam fokusuar në gjetjen dhe grumbullimin e literaturës juridike të shoqërive tregtare në aspektin e përafrimit me Legjislacionin tregtar të Bashkimit Evropian. Ky studim u bazua fillimisht në aspektin historik që në periudhat e mëparshme ku ne ende nuk kishim një autonomi legislative. Kjo duke përmëndur të gjitha hapat që u ndërmorën deri në momentin e arritjes sonë si shtet për lidhjen e një marrëveshje me rëndësi për ne.

Marrëveshja e Stabilizim Asocimit e kam vendosur fokusin tek kjo marrëveshje pasi fill pas kësaj ndodhën edhe ndryshimet në ligjin “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” nr.9901 datë 14.04.2008 pasi nisën edhe procedurat për integrim drejt Bashkimit Evropian. Për të arritur qëllimin e këtij punimi kam shqyrtuar rregulloret dhe direktivat mbi të cilat ligji ynë tregtar u bazua për të arritur standartet e përafrimit. Ku duke u referuar mbi to dhe mbi kërkesat e marrëveshjes vijoi procesin e tij të përmirësimit jo vetëm në atë sipërfaqësorë, por në lidhje me çdo situatë që shoqëritë tregtare haseshin. Që në momentin e regjistrimit në (QKB) liçensimit, paraqitjen e pasqyrave financiare, auditimit etj.



KREU 1

HISTORIKU DHE MARRËVESHJA STABILIZIM ASOCIMIT

1.1.Historiku i Ligjit për Shoqëritë Tregtare në Shqipëri

Legjislacioni tregtar shqiptar për të arritur në përshtatshmërinë që ka sot me legjislacionin e Bashkimit Evropian i është dashur të kalojë një sërë procesesh. Marrë kjo në aspektin fillestar kur Shqipëria sapo ishte shpallur një shtet i pavarur dhe nuk kishte një legjislacion të sajën në kuptimin tërësor, por edhe vetëm tregtarë. Hapat e ndërmarrë fillimisht më tepër se hapa të mirëfilltë ishin hapa drejt një zgjidhje të menjëhershme. Marrëdhëniet tregtare filluan të rregullohen nga e drejta osmane e më pas edhe me hyrjen e kodit tregtar më 1850 që ishte një përkthim i kodit tregtar francez. Që në këto momente nisi edhe rrugëtimi i përmirësimit juridik por i ndikuar në mënyrë të pashmangshme nga periudhat historike që ne si shtet kemi kaluar.

Gjatë mbretërimit të Ahmet Zogut shikohet qasja jonë si shtet drejt shtetit Italian ku më 1932 hyn në fuqi kodi tregtar shqiptar duke pasur si referencë kodin tregtar italian. Procesi për të krijuar një autonomi juridike ndërpritet për shkak të luftës së dytë botërore e fill pas saj në shtetin tonë zë vend partia komuniste me sistemin e ekonomisë së planifikuar duke hedhur kështu poshtë kodin tregtar të vitit 1932. Për një kohë relativisht të gjatë në aspektin tregtar, por jo vetëm, mbesim në vend numëro. Shqipëria e izoluar nuk mund të kishte bashkëpunim tregtar me asnjë prej shteteve qoftë edhe kufitare.

Por pas kësaj periudhe kishim një kalim nga ekonomia e planifikuar drejt ekonomisë së tregut, këtu ishte edhe kthesa jonë e parë drejt përmirësimit . Ku kemi tre ligjet kryesore të cilat kanë ndikuar në ekonominë e tregut. Ligji nr.7632 “Për pjesën e përgjithshme të Kodit Tregtar” ku dhënia e miratimi të këtij ligji është bërë me qëllim që më pas të miratohej edhe pjesa e posaçme e Kodit Tregtar gjë, e cila nuk u bë e mundur. Ligji nr.7638 “Për shoqëritë tregtare” që bënte përcaktimin e shoqërive tregtare të ndara në personi dhe kapitali. Më pas kemi edhe ligjin nr.9901 datë 14.04.2008, i cili merrte në konsideratë elemente të vlefshëm të ligjeve të mëparshëm në mënyrë që të ruhej sa më shumë që të ishte e mundur praktika



ligjore shqiptare e krijuar në periudhën 1994-2008.

Gjatë kësaj periudhe historike ajo që vlen të theksohet dhe është edhe arsyeja kryesore të planeve të kahershme dhe të tanishme për integrim është Marrëveshja e Stabilizim Asocimit. E nënshkruar në qershor të 2006-tës, e cila hyri në fuqi në prill të vitit 2009. Kjo marrëveshje zëvendësoi marrëveshjen e mëparshme me Komunitetin Ekonomik Evropian mbi tregtinë dhe bashkëpunimin ekonomik dhe atë tregtar, nënshkruar në maj të vitit 1992. Objektivi i kësaj qasje të re politike të BE-së ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor lidhet me rritjen e stabilitetit rajonal dhe parapërgatitjen e vendeve të rajonit për t'u integruar në Bashkimin Evropian.

Përpjekjet tona nuk kanë mbetur vetëm këtu, por në vitin 2011 Kuvendi i Shqipërisë miratoi një ndryshim në ligjin për shoqëritë tregtare, me qëllim përshtatjen e nivelit të kapitalit minimal të shoqërive aksionare , me kërkesat e Direktivës së Dytë të BE-së mbi Ligjin e Shoqërive. Dhe në vitin 2014, me qëllim harmonizimin e mëtejshëm me direktivat e reja të BE-së, Kuvendi i Shqipërisë miratoi disa shtesa dhe ndryshime të mëtejshme me karakter më thelbësor në ligjin për shoqëritë tregtare. Gjithashtu, me anë të këtyre shtesave dhe ndryshimeve synohej që të harmonizoheshin më tej dispozitat e ligjit për shoqëritë tregtare me disa akte të tjera ligjore shqiptare dhe të qartësoheshin disa çështje praktike që u hasën gjatë zbatimit të tij.

Si fund të kësaj hyrje vlen të themi që lista e akteve ligjore dhe nënligjore që kanë rregulluar dhe përmirësuar aktivitetin tregtar është e madhe, por për shkak të dinamizmit të ndryshimeve janë përmendur ligjet më të rëndësishme. Më tej do të vihen në fokus edhe ligje të tjera që kanë çuar sado pak drejt përafrimit të legjislacionit ton tregtar me atë evropian.

1.2. Angazhimi në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit

Në aspekt të përgjithshëm të përafrimit të legjislacionit dhe praktikës shqiptare me Acquis - në e BE¹, në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në nenin 122 është e parashikuar rëndësia që ka çdo marrëveshje e ratifikuar dhe botuar në fletoren zyrtare. "Çdo marrëveshje

¹Me Acquis të BE-së do të kuptojmë tërësinë e të drejtave dhe detyrimeve të përbashkëta që i bashkon të gjitha shtetet anëtare të BE-së. Janë 35 kapituj të Acquis të Bashkimit Evropian. Legjislacioni i BE i ka fillimet e tij prej vitit 1958 dhe njihet ndryshe me emrin EU Acquis



ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë . Pika 3 sanksionon se “një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të” . Këto dispozita përcaktojnë efektin e Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asocimit në sistemin ligjor dhe institucional shqiptar.

Megjithatë duhet pasur parasysh që këto parime aplikohen plotësisht për shtetet anëtare dhe jo për vendet candidate që janë palë në marrëveshjen e asocimit. Por pavarësisht kësaj ne si palë në marrëveshje e kemi të detyrueshëm përafrimin me sistemin ligjor evropian, dhe në fazën e parë të këtij përafrimi duhet të bëj pjesë “Ligji për shoqëritë tregtare”. Pasi në të vërtetë , ky ligj është një prej "elementeve themelore të acquis-së për tregun e brendshëm" (neni 70, pika 3)².

Për të qenë koherent dhe në përputhje me nenet e parashikuara të (MSA) Shqipëria është angazhuar që të përafroi legjislacionin e shoqërive tregtare me legjislacionin e BE. Në disa nene të marrëveshjes fokusi është ndalur vetëm në këtë ligj dhe ndryshimeve që u duhet bërë.Neni 49 kërkon që legjislacioni shqiptar të ketë koncepte të përcaktuara qartë për shoqëritë tregtare, filialet, degët dhe ndërmarrjet. Veç kësaj, duke dashur që të shfaqin sa më qartë qëllimin e kësaj marrëveshje se si ne kemi pëfitimet tona, por duhet të respektojmë edhe kompromise të tjera, neni 50 parashikon lehtësimin e fillimit të aktiviteteve në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga shoqëritë dhe qytetarët e BE-së, si dhe bashkëpunëtorët dhe degët e tyre. Neni 51 i MSA-së parashikon që çdo Palë mund të rregullojë vendosjen dhe funksionimin e shoqërive dhe shtetasve në territorin e saj, për sa kohë që këto rregullore nuk krijojnë diskriminim ndaj shoqërive dhe shtetasve të Palës tjetër në krahasim me shtetasit dhe shoqëritë e saj. Krijimi dhe zbatimi i një kuadri ligjor tregtar në përputhje me standardet e BE-së, krijimi i shoqërive tregtare, zvogëlimi i barrierave të hapjes së biznesit, thjeshtësimi dhe standardizimi i praktikave të biznesit në përputhje me praktikat ndërkombëtare.Kështu, tashmë në këtë fazë të procesit të para-anëtarësimit, organet e ndryshme shtetërore duhet të jenë të përfshira në ushtrimin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të acquis që është në fuqi.

Në kuadër të MSA-së, Partneriteti Evropian me Shqipërinë është instrumenti kryesor për të ndihmuar autoritetet shqiptare në realizimin e perspektivës evropiane të vendit. Parimi i

²Neni 70 MSA Gjatë fazës së parë të përcaktuar në nenin 6 të kësaj marrëveshje përafrimi do të përqëndrohet në elementët thelbësor të acquis të Tregut të brëndshëm ashtu si dhe në fusha të tjera të rëndësishme.



përgjithshëm i lëvizjes së lirë të mallrave, e cila është edhe një nga katër liritë themelore të Traktatit të BE-së nënkupton se produktet duhet të tregtohen lirisht nga një vend i Bashkimit Evropian në një tjetër. Lëvizja e lirë e mallrave është faktor kyç në rritjen dhe zhvillimin e tregut të brendshëm prandaj edhe nisma të tilla janë një favor i madh për tregun shqiptar. Ky parim është përcaktuar në nenet 34, 35 dhe 36 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFEU), duke parandaluar Shtetet Anëtare të miratojnë ose të mbajnë në fuqi kufizime të pajustificuara në tregtinë brenda BE-së. Këtu kemi të bëjmë me parimin e epërsisë, i cili aplikohet plotësisht vetëm në shtetet anëtare. Kjo nuk do të thotë që të mos kemi asnjë lloj ndalesë pasi mund të ndodhi që të bëhet për shkaqe të justifikueshme, të cilat janë për shkak të moralit publik, politikës publike ose sigurisë publike, mbrojtjes së shëndetit dhe jetës së njerëzve, ose mbrojtjes së pronës industriale dhe tregtare, si dhe kërkesave të tjera të detyrueshme të njohura nga Gjykata e Drejtësisë siç mund të jetë mbrojtja e mjedisit. Megjithatë, ndalesa të tilla duhet të mbeten proporcionale dhe nuk duhet të përbëjnë diskriminim arbitrar ose një kufizim të fshehtë në lidhje me tregtinë midis Shteteve Anëtare. Duhet theksuar që dispozitat administrative të rëndësishme duhet të miratohen për të zbatuar procedurat e njohjes reciproke të mallrave të tregtuara ligjërisht në një shtet tjetër anëtar, të përcaktuara në Rregulloren (EU) 2019/515 dhe shkëmbimit të informacionit në Rregulloren “Strawberry” (KE) Nr. 2679/98.

Në një numër sektorësh parimi i përgjithshëm plotësohet nga një kornizë rregulluese e harmonizuar. Legjislacioni i harmonizuar në lidhje me produktet evropiane, i cili duhet të transpozohet nga çdo shtet anëtar, përfaqëson pjesën më të madhe të *acquis*. Ajo bazohet në lënien mënjane të legjislacionit kombëtar i cili bie në kundërshtim me atë evropian dhe përjasjen drejt një legjislacioni të përbashkët. Prandaj përpjekjet tona të nisura që në kohët e hershme do ta bëjnë mjaft të thjeshtë adoptimin kur ne të jemi një shtet anëtar.³⁴

³Parimi i Epërsisë tregon mënyrën se si do të trajtohen konfliktet midis legjislacioneve të shteteve antare dhe legjislacionit të BE-së. Deklarata nr.17 që i bashkëngjitet traktatën themeluese konfirmon ekzistencën e këtij parimi. Gjykata e Evropiane e Drejtësisë (GJED) ka krijuar doktrinën e " epërsisë së legjislacionit të BE - së " në vijim të gjykimit se BE është një organizatë mbi nivelin kombëtar " (shih Çështjen gjyqësore 26 62 " Van Gend & Loos ") domethënë , një rend i ri juridik që është bërë më i madh sesa shuma e gjithë pjesëve të tij , dhe ku traktatet themeluese kanë një kuptim të ndryshëm krahasuar me traktatet ndërkombëtare .

⁴ Kjo rregullore imponon detyrimin për të justifikuar qartë arsyen pse qasja në treg është kufizuar ose mohuar.



KREU II

LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE

2.1. Legjislacioni për Shoqëritë Tregtare

Shoqëritë tregtare janë produkt dhe pjesë e shoqërive bashkëkohore . Ato janë organizata që ndërthurin "faktorë" të ndryshëm (kapitalin, krahun e punës, teknologjinë, si dhe mjedisin e tyre natyror, njerëzor dhe social) për qëllime të dobishme. Ato janë një instrument i frytshëm për ushtrimin e aktivitetit tregtar, sidomos kur ndërmarrja është rritur në një masë të tillë që e bën të vështirë administrimin nga pak persona, dhe sidomos kur ndërmarrja kërkon të rrisë vlerën e fondeve në dispozicion. Kjo e bën më të qartë dhe të nevojshme krijimin e një legjislacioni për këto shoqëri gjë të cilën ne prej vitesh e kemi. Legjislacioni për shoqëritë tregtare përfshin rregulla mbi formimin, regjistrimin, bashkimin dhe ndarjen e kompanive. Është ligji për shoqëritë tregtare ai, që përcakton një zgjidhje të përshtatshme për konsultimin me punëmarrësit, ku drejtuesit e shoqërisë dhe përfaqësuesit e punëmarrësve të çdo shoqërie kanë mundësinë që të arrijnë marrëveshje për përfshirjen e përfaqësuesve të punëmarrësve në nivelin e këshillit të administrimit.

Lidhur me këtë çështje, Shqipëria zgjodhi qasjen që aplikon legjislacioni evropian, për shoqëritë tregtare, duke njohur përfshirjen e negociuar të punëmarrësve në procesin vendimmarrës, me anë të:

- *Rregullores (KE) 2157/2001 për statutin e shoqërisë tregtare evropiane .*

Përmbajtja e rregullores e ka fokusin e saj kompletimin e tregut të brendshëm dhe përmirësimi që sjell ky kompletim në situatën ekonomike dhe sociale të të gjithë Komunitetit. Kjo nënkupton jo vetëm heqjen e barrierave ndaj tregtisë, por edhe që strukturat e prodhimit duhet t'i përshtaten dimensionit evropian. Për këtë qëllim është thelbësore që kompanitë, biznesi i të cilave është i kufizuar në plotësimin e nevojave thjesht lokale, duhet të jenë në gjendje të planifikojnë dhe të kryejnë riorganizimin e biznesit të tyre në një shkallë të gjërë.



Kjo rregullore përpiqet të sjell një rregullim edhe në kuadrin ligjor ku zhvillimi i një biznesi apo shoqërie tregtare vijon mbi ligjet kombëtare dhe për këtë arsye nuk korrespondon me kuadrin ekonomik brenda të cilit duhet të zhvillohet. Kjo situatë përbën një pengesë të konsiderueshme për krijimin e grupeve të kompanive nga shtete të ndryshme anëtare. Shtetet anëtare janë të detyruara të sigurojnë që dispozitat e zbatueshme për kompanitë evropiane sipas kësaj rregulloreje të mos rezultojnë as në diskriminim që rrjedh nga trajtimi i ndryshëm i pajustificuar i kompanive evropiane në krahasim me shoqëritë publike me përgjegjësi të kufizuar ose në kufizime joproporcionale në formimin e një shoqërie evropiane ose për transferimin e zyrës së saj të regjistruar.

- *Direktiva 2004/25/KE për marrjet e ofertave të blerjeve*

Përcakton rregullat e harmonizuara për të lehtësuar blerjet ndërkufitare brenda BE-së, si dhe përmirësimin e transparencës dhe mbrojtjen e aksionarëve të pakicave në kontekstin e marrjeve të tilla. Shtetet me anë të kësaj direktive duhet të ofrojnë informacionin e nevojshëm në lidhje me ofertat e blerjes që janë bërë në tregjet e tyre të rregulluara. Gjithashtu duhet pasur parasysh që shtetet anëtare të cilët nuk i përmbahen kësaj direktive do të hasen me sanksione për çdo shkelje.

- *Direktiva (89/666/KEE) parashikon gjithashtu kërkesat për dhënien e informacioneve shpjeguese në lidhje me degët e hapura në një Shtet Anëtar të qeverisur nga ligji i një shteti tjetër.*

Duke pasur parasysh se për të siguruar qëllimet e kësaj direktive është shmangur çdo diskriminim në bazë të vendit të origjinës së kompanisë, kjo direktivë duhet të mbulojë gjithashtu degët e hapura nga shoqëritë e rregulluara nga ligji i vendeve joanëtare dhe të krijuara në forma ligjore të krahasueshme me këto kompani.

- *Direktiva 2012/17/BE për ndërlidhjen e regjistrave qendrorë, tregtarë dhe të shoqërive*

Përcakton krijimin e sistemit të interkonjeksionit të regjistrave të biznesit, që përfshin një platformë qendrore evropiane përmes së cilës regjistrat kombëtarë të biznesit do t'i bëjnë të disponueshme informacionet e tyre në lidhje me mekanizmat e zbulimit ndërkufitar, duke përfshirë edhe portalin e-Drejtësisë.



- *Direktivës 2002 / 14 / KE për informimin e punëmarrësve dhe konsultimin me ta.*

Parlamenti Evropian dhe Këshilli i bashkimit Evropian, e kanë miratuar këtë direktivë duke pasur parasysh Traktatin për themelimin e Komunitetit Evropian, në veçanti nenin 137(2) të tij. Gjithashtu edhe në paragrafin 17 të Kartës së Komunitetit për të Drejtat Themelore Sociale të Punëtorëve parashikohet, ndër të tjera, se "informimi, konsultimi dhe pjesëmarrja e punëtorëve duhet të zhvillohet në një mënyrë të përshtatshme, duke marrë parasysh procedurat në fuqi në shtetet e ndryshme anëtare.⁵

- *Direktiva 2004/109/KE kërkon harmonizimin e kërkesave të transparencës në lidhje me shoqëritë e listuara.*

Zbulimi i informacionit të saktë, gjithëpërfshirës dhe në kohë në lidhje me emetuesit e letrave me vlerë ndërton besim të qëndrueshëm të investitorëve dhe lejon një vlerësim të informuar të performancës së biznesit dhe asetëve të tyre. Kjo rrit mbrojtjen e investitorëve dhe efikasitetin e tregut.

2.2. Përmirësime të sjella në Tregun e Shoqërive Tregtare

Ligji për shoqëritë tregtare është hartuar si një ligj i përafëruar, dhe për pasojë zbatimi dhe interpretimi i tij bazohet në standardet dhe interpretimet evropiane. Kanë qenë mjaft akte ligjore Evropiane të cilat janë marrë parasysh në momentin e ligjit për shoqëritë tregtare dhe më vonë në përmirësimin e tij. Ku mund të përmendim Direktivën 2005/56/KE "Për bashkimet ndërkufitare të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar" të amenduar. Ligji rregullon procedurat, autoritetet përgjegjëse të përfshira në rastet e shkrirjes së jashtme dhe të brendshme ndërmjet një shoqërie shqiptare dhe një shoqërie të themeluar në një shtet anëtar të BE-së, duke lehtësuar bashkimin pa kaluar në likuidim.⁶

Duke dashur që të bëhen edhe më tej përmirësimin përse i përket procesit të depozitimit të pasqyrave financiare në regjistrin tregtar, është implementuar projekti "*Përmirësimi i cilësisë*

⁵ Të gjitha dokumentet në fjalë janë lehtësisht të aksesueshme në <https://european-union.europa.eu/select-language?destination=/node/1>

⁶ Kjo direktivë lehtëson bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar. Ligjet e Shteteve Anëtare duhet të lejojnë bashkimin ndërkufitar të një shoqërie tregtare të brendshme me përgjegjësi të kufizuar, me një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar të një Shteti Anëtar tjetër, nëse legjislacioni i brendshëm i Shteteve Anëtare në fjalë e lejon bashkimin ndërmjet shoqërive tregtare të këtyre llojeve.



së *Raportimit Financiar*” me ndihmën e Bankës Botërore. Ky projekt bën të mundur përcaktimin saktësisht të dokumentave që do të hartohen nga subjektet, porë kjo në varësi të disa kritereve përsa i përket:

- Klasifikimit gjatë procesit të raportimit financiar
- Rritja e transparencës për veprimtaritë ekonomike dhe financiare
- Zbatimi i sistemit të ri për dërgimin e deklaratave të shërbimit në QKB nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania
- Përpunimi i raporteve për të dhënat e pasqyrave financiare

Një tjetër çështje ku do të doja të ndalesha për të treguar edhe më tepër për nismat e marra të vendit tonë përsa i përket përgatitjes së tij për anëtarësim. Është edhe marrëveshja që nënshkroi në 2020 Qendra Kombëtare e Biznesit për pjesëmarrjen e regjistrit tregtar shqiptar në Portalin Rajonal të Regjistrave tregtar. Falë këtij projekti, mundësohet komunikimi në kohë reale i të dhënave të besueshme, të përditësuara për të gjitha subjektet tregtare të regjistruara në regjistrat tregtarë të vendeve pjesëmarrëse, si dhe baza për krijimin e shërbimeve globale për të gjitha subjektet në vendet pjesëmarrëse. Portali do të mundësojë gjithashtu ndërlidhjen e bizneseve shqiptare me ato të rajonit, duke mundësuar rritjen e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar të vendeve të rajonit.

Bazuar në rekomandimet e MONEYVAL, është miratuar Ligji Nr. 112/2020, “*Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues*”, dhe aktet nënligjore përkatëse. Me miratimin e këtij ligji, u bë i mundur përcaktimi i pronarit përfitues, subjekteve raportuese që kanë detyrimin ligjor të regjistrojnë në regjistër të dhënat e pronarëve të tyre përfitues dhe procedura dhe afatet e nevojshme për regjistrimin e të dhënave të pronarët përfitues. Me miratimin e këtij ligji, u krijua Regjistri i Pronarëve Përfitues, i cili administrohet nga QKB. Regjistri i Pronarëve Përfitues është një bazë të dhënash elektronike shtetërore, në të cilën regjistrohen të dhënat e pronarëve përfitues të subjekteve që kanë detyrimin t’i raportojnë, i cili mbledh në kohë reale të dhënat e regjistruara në regjistrat shtetërorë përkatës të administruar nga institucionet shtetërore përkatëse, si dhe shërben si arkiv zyrtar elektronik dhe siguron transparencë në fushën e pronarëve përfitues. Më 14.05.2020 u miratua Ligji 62/2020 “*Për tregjet e kapitalit*”, i cili hyri në fuqi më 01.09.2020. Ligji “Për tregjet e kapitalit” është përafëruar pjesërisht me Direktivën e Tregjeve në Instrumentet Financiare (MIFID II), si dhe me Direktivën 2004/109/KE mbi harmonizimin e kërkesave të transparencës në lidhje me



informacionin letrat me vlerë të cilëve pranohen të tregtohen në një treg të rregulluar.⁷

2.3. Rregullat e përcaktuara në raport Financiar, Kontabilist dhe Auditim

Në kuadrin më të gjerë ligjor për aktivitetet e shoqërive tregtare përfshihen dispozitat e përgjithshme të një sërë aktesh të tjera ligjore e nën ligjore, përfshi këtu, si për shembull dispozitat për regjistrimin dhe dhënien e informacioneve; aktet për kontabilitetin dhe auditimin ligjor, si dhe për kushtet që duhet të plotësojnë auditorët; legjislacioni për shërbimet financiare, përfshirë krijimin e një enti rregullator të shërbimeve financiare etj. Zbatimi i këtyre akteve ligjore dhe nënligjore varet nga metodat dhe procedurat që janë përcaktuar gjatë ecurisë së sistemit ligjor në vend.

Në fushën e raportimit financiar, acquis përcakton rregulla për paraqitjen e llogarive vjetore dhe të konsoliduara, përfshirë rregullat e thjeshtuara për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Zbatimi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit është i detyrueshëm për disa subjekte të interesit publik. Për më tepër, acquis përcakton rregulla për miratimin, integritetin profesional dhe pavarësinë e auditimeve ligjore. Ligji për shoqëritë tregtare tashmë është vendosur në mënyrë të kënaqshme në një kontekst kombëtar të përafëruar . Sidoqoftë , miratimi i akteve ligjore të tjera në vijim nga BE-ja (sidomos në sektorin financiar)do të ketë ndikim edhe mbi ligjet shqiptare të fushës.

Në fushën e kontabilitetit, acquis përfshin njohjen, vlerësimin dhe shpalosjen e rregullave dhe skemave për bilancin dhe llogarinë e fitimit dhe humbjes për pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara (Direktiva 2013/34/BE) të shoqërive publike dhe private me përgjegjësi të kufizuar. Kjo direktivë gjithashtu përcakton se kush ka nevojë për një auditim, si dhe detyrimet e publikimit. Përveç kësaj, Rregullorja (KE) Nr. 1606/2002 mbi aplikimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, kërkon që shoqëritë tregtare të BE-së të listuara në një treg të rregulluar të hartojnë pasqyrat financiare të tyre të konsoliduara në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të cilat janë miratuar nga Bashkimi Evropian. Sipas kësaj rregulloreje, Shtetet Anëtare gjithashtu mund të vendosin të zbatojnë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për pasqyrat financiare individuale dhe/ose të konsoliduara të shoqërive tregtare. Në zbatim të kësaj rregulloreje është edhe shteti ynë.

⁷Direktiva e Tregjeve në Instrumentet Financiare (2004/39/KE) Ka qenë e zbatueshme në të gjithë Bashkimin Evropian që nga nëntori 2007. Është një gur themeli i rregullimit të BE-së për tregjet financiare që kërkon të përmirësojë konkurrencën e tyre duke krijuar një treg të vetëm për shërbimet dhe aktivitetet e investimeve dhe për të siguruar një shkallë të lartë të mbrojtjes së harmonizuar për investitorët në instrumentet financiare.



Direktiva 2006/43/KE për auditimet ligjore harmonizon rregullat duke përfshirë, ndër të tjera, miratimin dhe regjistrimin e audituesve ligjorë, sigurimin e jashtëm të cilësisë, mbikëqyrjen publike, pavarësinë e audituesit dhe zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit(SNA). Amendimi i Direktivës 2014/56/BE përcakton kërkesat shtesë për të përmirësuar cilësinë e auditimit, me fokus në pavarësinë e audituesit, raportet e auditimit dhe mbikëqyrjen e auditimit publik. Rregullorja e re 537/2014/BE paraqet kërkesa specifike lidhur me auditimin ligjor të Njësive të Interesit Publik (NJIP). NJIP-të janë institucione të kreditit, shoqëri të listuara, ndërmarrje të sigurimeve, dhe subjektet të tjera të përcaktuara si të tilla nga Shtetet Anëtare. Rregullorja gjithashtu paraqet kërkesa specifike për organizimin e sistemit të mbikëqyrjes publike të audituesve ligjorë dhe kontrollon firmat e auditimit të cilat auditojnë PIE-të.



KREU III

PËRGATITJA E SHQIPËRISË PËR ANËTARËSIM

3.1. Përgatitja e Shqipërisë për anëtarësim në fushën e së drejtës për Shoqëritë Tregtare

Duke u nisur nga raportet dhe vlerësimet e nxjerra prej disa kohësh e deri më tani vlen të themi që përgatitja e shqipërisë për anëtarësim edhe pse me hapa jo galopantë është mesatarisht e përgatitur. Them jo galopantë pasi edhe në vlerësimet e dhëna dy vitet e shkuara kanë pasur të njëjtën arritje. Kjo arritje mesatare nuk është vetëm të drejtës për shoqëritë tregtare, por edhe në kritere të tjera.

- Sipas raportit të progresit të BE-së 2021, në periudhën raportuese është bërë progres në disa çështje: Përmirësimi në transparencën e pasqyrave financiare të kompanive në regjistrin e biznesit
- Në përafrimin e mëtejshëm të kornizës së saj me acquis të BE-së në raportimin jofinanciar dhe në raportimin e qeverisjes së korporatës.

Por gjithsesi, nuk ka pasur progres në rekomandimin lidhur me ligjin për shoqëritë tregtare. Sipas raportit të BE-së, në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti të vendosi fokusin e saj për të bërë përmirësime në:

- Rishikimin e legjislacionit ekzistues në fushën e ligjit për shoqëritë tregtare me qëllim identifikimin e ndryshimeve të nevojshme për të përfunduar përafrimin me acquis të BE-së,
- Përafrimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor për kontabilitetin dhe auditimin me acquis më të fundit të BE-së në këto fusha.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të vijojë me procesin e analizës së mangësive ligjore dhe kryerjes së amendimeve të ligjit të shoqërive tregtare. Bazuar në Ligjin Nr. 9723/2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, pasqyrat financiare depozitohen dhe publikohen në regjistrin tregtar. Duke filluar nga viti 2015, procesi i depozitimit të pasqyrave financiare



bëhet tërësisht elektronik përmes portalit qeveritar e-Albania. Në vitin 2019, me asistencën teknike dhe financiare, në QKB u zbatua një sistem i modernizuar i raportimit elektronik për depozitimin dhe publikimin e pasqyrave financiare. Pra, ligjërisht dhe teknikisht, është mundësuar që pasqyrat financiare dhe raportet përkatëse të depozitohen në mënyrë elektronike në regjistrin tregtar.

Momentalisht gjatë këtij viti, në planin për integrim bëhet me dije që po punohet për publikimin e një prej raporteve të dorëzuara nga subjektet, së bashku me pasqyrat financiare, që për arsye teknike nuk kanë mundur të publikohen. Në fushën e së drejtës tregtare, legjislacioni shqiptarë në tërësi është në përputhje me acquis të BE-së, kjo duke u bazuar më së shumti në rekomandimet e adresuara nga Komisioni Evropian. Ligji Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” rregullon formimin, organizimin dhe zhvillimin e organizatave të biznesit në Shqipëri. Ligji përputhet kryesisht me legjislacionin përkatës të BE-së, me amendimet e bëra me kalimin e kohës.

Progres i mëtejshëm është bërë me miratimin e Ligjit Nr. 110/2012 “Për bashkimet ndërkufitare të shoqërive tregtare” që përaftron legjislacionin shqiptar me kërkesat e direktivës 2005/56/KE të BE-së, datë 26 tetor 2005 “Për bashkimet ndërkufitare të shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar”. Duke vijuar më tej edhe me shtesat edhe përmirësimet e bëra në vitin 2014 në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Nismë kjo e marrë me qëllim harmonizimin e mëtejshëm me direktivat e reja të BE-së.

Kuvendi i Shqipërisë i miraton këto shtesa dhe ndryshime të mëtejshme me karakter thelbësor në ligjin për shoqëritë tregtare. Gjithashtu, me anë të këtyre shtesave dhe ndryshimeve synohet që të harmonizoheshin më tej dispozitat e ligjit për shoqëritë tregtare me disa akte të tjera ligjore shqiptare dhe të qartësoheshin disa çështje praktike që u hasën gjatë zbatimit të tij.

Në këtë punim merret në konsideratë edhe lidhja midis dy ligjeve i ligjit për shoqëritë tregtare, duke nisur nga viti 2008 deri në vitin 2014, kjo duke dashur të jepet një përshkrim shumë i shkurtër i situatës përpara vitit 2008. Dhe ligji nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit "(QKR)", i cili u hartua në verën e vitit 2007, janë dy ligje që lidhen ngushtë dhe janë tejet të rëndësishëm për njëri-tjetrin.

Dispozitat e legjislacionit tregtar duhen kërkuar në ligjin për shoqëritë tregtare dhe në ligjin për regjistrimin e biznesit. Nuk dua të ndalem në mënyrë të hollësishme tek historiku i këtyre



ligjeve pasi e kam dhënë një përshkrim të tillë në fillim të punimit, por për të parë përgatitjen dhe hapat e ndërmarrë për këtë përafrim shkurtimisht do të ndalem në procesin e reformimit të ligjit për shoqëritë tregtare prej vitit 2007, kur qeveria shprehu vullnetin për reformimin e një strukture të përcaktuar qartë posaçërisht për veprimtaritë civile dhe tregtare dhe për organizatat tregtare, në bazë të këtyre ligjeve:

Ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", që parashikon format kryesore të organizimit të biznesit, Ligji për regjistrimin e biznesit (QKB), që parashikon regjistrimin dhe licencimin e biznesit si dhe për marrjen e informacioneve të organizatave të biznesit. QKB administron regjistrin tregtar që është i njohur si një bazë të dhënash shtetërore, të cilat janë unike, e ndarë në dosje të veçanta elektronike për secilin subjekt që ka detyrimin e regjistrimit dhe lejet e lëshuara në Shqipëri.

Ligji Nr. 9723, datë 3.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", është amenduar në shkurt të vitit 2015 me Ligjin Nr. 8/2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007" "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar, duke u përshtatur më tej me Direktivën 2009/101/KE me qëllim dorëzimin në formë elektronike të bilanceve vjetore dhe raporteve të auditimit nga shoqëritë tregtare. Subjekti do të regjistrojë dhe dorëzojë në regjistrin tregtar, pasqyrat financiare vjetore, raportin e progresit të aktivitetit dhe raportin e auditimit, të mbajtur në përputhje me kërkesat ligjore, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme jo më vonë se 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar. Dorëzimi i tyre bëhet në mënyrë elektronike nëpërmjet portalit e-Albania që prej vitit 2015. Kjo duke ofruar shërbimet online pa kosto.

Ndërkohë, duke filluar nga vitit 2020, shërbimet e regjistrimit të personave fizikë, pezullimit dhe aktivizimit të aktivitetit të subjekteve, si dhe pajisjes me licencë/leje ofrohen vetëm online nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania.⁸

AKSHI, si institucioni përgjegjës për administrimin e portalit qeveritar e-Albania, ka bërë me dije se shërbimet e mbetura për personat juridikë janë gati dhe, pasi të implementohen dhe të testohen, do të jenë gati për t'u përdorur nga biznesi deri në fund të vitit 2021. Sigurisht duke u ndodhur në një situatë goxha koherente duhet të përmëndim që sulmi i beftë kibernetik. Një ngjarje aspak favorizuese pasi siç e lart përmënda informacionet e shumë organizatave, por sigurisht edhe të çdo shtetasi shqiptarë ishte e aksesueshme aty. Ajo që mendohet në të tilla

⁸Në bazë të ligjit nr.131/2015, funksionet e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) kryhen tashmë nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)



kushte është që sulmi kibernetik do të kishte gjasa të pakta për të ndodhur nëse siguria e portalit do të ishte më e madhe dhe aftësia për kundërpërgjigje ndaj këtyre sulmeve të ishte më profesionale. Ne vërtetë ndërmorëm hapa drejt përafrimit me legjislacionin e BE-së, por sa të sigurt ishin këto hapa? E-Albania ishte një opsion mjaft i mirë për çdo biznes, shoqëri tregtare apo qytetar, por siguria dhe integriteti është primare për çdo kënd.

Pas këtij riorganizimi, janë miratuar edhe disa ligje dhe dispozita të tjera që nuk janë të detyrueshme. Synimi i ligjit për shoqëritë tregtare ishte sanksionimi i një sistemi të thjeshtë, të qartë dhe të përditësuar, i aftë për të thithur investime të huaja dhe për të siguruar harmonizimin e dispozitave të tij me legjislacionin evropian të shoqërive tregtare, përfshirë direktivat përkatëse. Rrjedhimisht, ligji për shoqëritë tregtare pasqyron standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare lidhur me të drejtën tregtare, drejtimin e brendshëm të shoqërive tregtare dhe përgjegjësinë sociale të shoqërive tregtare. Legjislacioni evropian ndryshon shpesh, dhe për rrjedhojë, legjislacioni shqiptar duhet të ndjekë ritmin e zhvillimeve të reja në nivel evropian. Ligji shqiptar për shoqëritë tregtare i vitit 2008 përputhet me sistemet e reja rajonale të së drejtës tregtare, aspekt ky i rëndësishëm që pasqyron kërkesën për integrim rajonal dhe marrëdhënie ekonomike rajonale⁹.

3.2. Përafrimi i legjislacionit në fushën e Kontabilitetit

Kur flasim për shoqëri tregtare apo biznes menjëherë fokusi ynë shkon drejt fitimi që ato kanë. Rrugën dhe standartet që ato ndjekin për të arritur aty ku dëshirojnë. Nëse standardet që ndjekin këto shoqëri të tregut shqiptar janë në përputhshmëri me standartet ndërkombëtare. Prandaj edhe një fushë tjetër me rëndësi ku do të ndalem është edhe kontabiliteti i korporatave, patjetër edhe këtu ishte e nevojshme të ndodhnin disa ndryshime që çonin drejt integritit. Në fushën e kontabilitetit, që prej vitit 2008 janë shpallur të detyrueshme për zbatim *Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar* duke përfshirë përditësimet e vazhdueshme dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Standardet Kombëtare të Kontabilitetit janë miratuar nga viti 2008 dhe ndryshimet e tyre janë miratuar që nga korriku 2014 me hyrje në fuqi më 1 janar 2015. Kërkesat e standardeve

⁹Shih : Kodi i drejtimit të brendshëm të shoqërive tregtare ; Ligji për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare (ligji nr . 110/2012)



kombëtare të përmirësuara janë në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) për Ndërmarrjet e Mesme dhe të Vogla ndërsa paraqitja e pasqyrave financiare pra e të ardhurave dhe shpenzimeve është plotësisht e përafuar me kërkesat e Direktivës së BE-së 2013/34 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, e amenduar (Direktiva e Kontabilitetit).

Në këtë pikë, është arritur progres në drejtim të përafrimit të legjislacionit shqiptar me acquis e BE-së në fushën e kontabilitetit të korporatave përmes miratimit të ligji të kontabilitetit Nr.25 datë 10.05.2018 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, i cili synonte përafrimin e mëtejshëm me acquis në fushën e kontabilitetit të shoqërive tregtare, konkretisht me Direktivën Nr.2013/34/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian të datës 26 qershor 2013, ku progres vihet re dhe në zbatimin e këtij ligji. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të harmonizuar legjislacionin me acquis për pasqyrat financiare vjetore dhe të konsoliduara. Kapaciteti i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, i cili përkthen pa ndryshime nga origjinali SNRF-të, harton dhe mirëmban standardet e kontabilitetit si dhe monitoron zbatimin e të dyja seteve të raportimit financiar, duhet të përforcohet dhe më shumë.

Gjithsesi, në ndryshimet ligjore të reja, në ligjin e ri të kontabilitetit, është parashikuar detyrë specifike për Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, në nenin 24, pika f) e cila përcakton “*të monitorojë zbatimin e standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar*”, e cila nuk ka qenë e përfshirë në ligjin e mëparshëm. Vlen të theksojmë që, nëpërmjet përdorimit të SNRF-të në Shqipëri, të cilat janë të detyrueshme, kemi përafrim të plotë me Rregulloren Nr. 1606/2002 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian të datës 19 Korrik 2002 mbi zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit.

Që nga viti 2008, sipas Ligjit Nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, të amenduar, janë përkthyer rregullisht në gjuhën shqipe, nën përgjegjësinë e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit (KKK), të gjitha ndryshimet ose thënë ndryshe përmirësimet e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, siç është publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB), Londër. Ndryshimet e SNRF-ve bëhen të detyrueshme me Urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë si dhe publikohen në faqen elektronike të MFE dhe KKK.

Për vitin 2021 janë miratuar:

- Urdhri Nr. 164, datë 08.09.2021 “*Për shpalljen e përkthimit në gjuhën shqipe të*



ndryshimeve të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit nr. 12 “Tatimet mbi të Ardhurat”

- Urdhri Nr. 134 datë 21.07.2021 “Për ndryshimin e referencës ligjore në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara”
- Urdhri Nr. 96 datë 25.5.2021 “Për miratimin e përkthimit në gjuhën shqipe të ndryshimeve të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar”,
- Urdhri Nr. 101 datë 25.5.2021 “Për miratimin e përkthimit në gjuhën shqipe të ndryshimeve në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 16 “Qiratë”. Në përputhje me praktikën vjetore të BSNK-së, përgatitet dhe publikohet versioni i konsoliduar i SNRF-ve në gjuhën shqipe në faqen e internetit të KKK.

Legjislacioni tregtar shqiptar duke dashur që të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe duke ndjekur udhëzimet dhe rekomandimet e dhëna nga Komisioni Evropian menjëherë pasi Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit botoi “Udhëzuesin për hartimin e raportit jo-financiar ndërmori hapat e nevojshëm për përshtatshmëri. Në fund të po atij viti nën vrazhdën e udhëzuesit përfunduan duke sjell nën standardetkombëtare të kontabilitetit: Inventarët, Aktivët afatgjatë, qiratë,kombinimin e bizneseve dhe aktivët biologjike. Gjithashtu dhe është publikuar Rekomandimi për cilësinë e Raportit të drejtimit të brendshëm (raporte që kërkohen në nenet 18 dhe 19 të ligjit Nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”. Janë monitoruar nga KKK pasqyrat financiare të 50 njësive ekonomike, nga të cilat 25% janë njësi ekonomike me interes publik.

Në kuadër të rekomandimit të KE, ku sipas së cilit në fushën e kontabilitetit të shoqërive ligji i ri për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare është përafuar pjesërisht me Direktivën, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ka rishikuar shënimet shpjeguese për njësitë e vogla të përcaktuara në SKK, në mënyrë që t’i pakësojë ato në masën e parashikuar në Direktivën 34/2013. Shënimet shpjeguese kanë përfunduar dhe janë publikuar për komente në faqen e KKK. Në korrik 2021 janë publikuar për komente ndryshimet e shënimeve shpjeguese të setit të plotë të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit. Sipas rregullores afati për komente mund të shtyhet deri në 6 muaj me miratim të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit. Së fundmi, ka përfunduar rishikimi i të gjithë udhëzuesve për zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit.



3.3. Përafrimi i legjislacionit në fushën e Auditimit

Auditimi është një vlerësim i një çështjeje ndaj një grupi specifik kriteresh, në mënyrë që të japë një mendim nëse çështja e subjektit është përfaqësuar në mënyrë të drejtë. Forma më e zakonshme e auditimit është një kontroll financiar, ku siç do ta shikojmë edhe më poshtë në temën tonë auditimi ligjor ka të bëjë me mbikëqyrjen dhe vlerësimin burimet financiare duke dhënë siguri për vlerësimet e kryera. Ky koncept synon të sigurojë një opinion të pavarur për “të vërtetën dhe ndershmërinë” e një grupi të pasqyrave financiare. Prandaj, një audit është një mënyrë që aksionerët të fitojnë rehati që pasqyrat financiare të përgatitura nga menaxherët janë një pasqyrim i drejtë i performancës së kompanisë. Edhe në këtë aspekt në sistemin ligjor tregtar shqiptar janë bërë mjaft rregullime duke u qasur drejt ndërkombëtarizimit.

Ndryshimi i parë ishte në Ligjin Nr. 10091 datë 5.03.2009 *“Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar”*, ligj i cili me ndryshimet e reja synoi krijimin e bordit të mbikëqyrjes publike si një strukturë e përhershme nga burimet e veta financiare. Standart ky i vënë në fokus nga BE. Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP), i themeluar si autoritet i pavarur rregullator me burimet e tij financiare shërben për të realizuar mbikëqyrjen publike dhe për të siguruar që audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit të jenë subjekt i një sistemi që jep siguri për cilësinë e auditimeve të kryera. Gjatë vitit 2019, në zbatim të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 të auditimit ligjor, është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.17 datë 16.01.2019 *“Për përcaktimin e shoqërive të tjera shtetërore ose private, të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre”*.

Ky bord gjatë viteve të fundit pra flasim për periudhën 2018-2021 u fokusua në krijimin e një rregullatori, si kërkesë e parashikimeve ligjore, duke hartuar e miratuar një sërë rregulloresh që lidhen me funksionimin e strukturës së tij mbështetëse, mbledhjen e të ardhurave, investigimin dhe disiplinën. Bordi i Mbikëqyrjes Publike ka emëruar *Komisionin e Investigimit dhe Disiplinës*, i cili prej korrikut të vitit 2019 ka propozuar marrjen e masave



disiplinore për auditues ligjorë/shoqëri auditimi, si dhe në shqyrtim të kontabilistëve të miratuar në proces.

Në kuadër të zbatimit të aktiviteteve kryesore të tij, BMP luan rol aktiv për bashkëpunimin me institucione të tjera të tilla si, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe institucione të tjera rregullatore me qëllim realizimin e vizionit mbikëqyrës. Në këtë kuadër është zhvilluar më tej bashkëpunimi ndërmjet BMP-së dhe rregullatorëve financiarë (Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare) me fokus në çështjet e auditimit. Bordi i Mbikëqyrjes Publike është gjithashtu në proces të përmbushjes së gjithë kërkesave të parashtruara në rekomandimet FATF ku më pas raporti sesa janë marrë parasysh këto rekomandime¹⁰ nxirrej nga MONEYVAL.¹¹Në këtë kuadër, të tilla kërkesa janë përfshirë edhe në procesin e kontrollit të cilësisë së audituesve ligjorë dhe kontabilistëve të miratuar.

Bordi Mbikqyrjes Publike ka realizuar një proces mbikëqyrje që mbështetet mbi një analizë risku dhe një metodologji të mirëfilltë në kryerjen e kontrollit të cilësisë ndaj auditimeve ligjore. Me qëllim rishikimin e cilësisë së auditimit dhe sigurimin e promovimit të përmirësimit të cilësisë së auditimeve në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, BMP gjatë 2019–2021 ka realizuar: inspektimin e 19 shoqërive audituese dhe 30 angazhimeve individuale prej këtyre shoqërive të auditimit. Ndërkohë, në të njëjtën periudhë kohore është realizuar inspektimi tematik për çështje të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit për 8 subjekte të tjera. Kjo nisëm është marrë edhe për shkak të raportimeve të viteve të mëparshëm ku Shqipëria nuk ka përmirësuar pavarësisht masave për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit në përputhje me rekomandimet e marra.

Nga raportimi u identifikuan mangësi me pajtueshmërinë teknike në lidhje me sanksionet e synuara financiare, transparencën e rregullimeve ligjore, mbikëqyrjen e institucioneve

¹⁰ Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (FATF) është një organ ndërqeveritar i themeluar në vitin 1989 nga Ministrat e vendeve anëtare. FATF përcakton standartet dhe të nxit zbatimin efektiv të masave ligjore, rregullative dhe operacionale për luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe kërcënime të tjera që lidhen me integritetin e sistemit financiar ndërkombëtar. FATF, në bashkëpunim me organizma të tjerë ndërkombëtar, punon gjithashtu për të identifikuar dobësitë në nivel kombëtar me qëllim mbrojtjen e sistemit financiar ndërkombëtar nga keqpërdorimi.

¹¹ Masa kundër pastrimit të parave dhe financimit kundër terrorizmit. Kundër pastrimit të parave dhe kundër terrorizmit masat e financimit.



financiare dhe bizneseve dhe profesioneve jo-financiare. Prej korrikut të vitit 2019 është bërë e mundur zbatimi i rregullores Nr.4 *“Për investigimin dhe procedurat e marrjen e masave disiplinore”* nëpërmjet krijimit të strukturave të përshtatshme, për implementimin e saj, si pjesë integrale e Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

Në kuadër të rekomandimeve të KE, ku evidentohet se Shqipëria duhet të vazhdojë të forcojë kapacitetin e BMP dhe të harmonizohet me rregullat e auditimit ligjor, gjatë vitit 2021 janë ndërmarrë disa nisma:

- Bordi i Mbikëqyrjes Publike ka emëruar Komisionin e Investigimit dhe Disiplinës, i cili prej korrikut të vitit 2019 ka propozuar marrjen e masave disiplinore për 31 auditues ligjorë/shoqëri auditimi.
- Për herë të parë, Bordi i Mbikëqyrjes Publike ka publikuar renditjen në tregun e auditimit për personat fizikë dhe personat juridikë të ndarë përkatësisht sipas formës së organizimit, duke konsideruar volumin e të ardhurave nga shërbimet e auditimit dhe volumin e numrit të klientëve. Publikimi i konsoliduar i renditjes, sipas këtyre dy kriterëve, është bërë pavarësisht formës juridike të organizimit. Ky publikim është i pari në llojin e tij në 23 vite që ekziston profesioni kontabël.
- Në zbatim të rregullores Nr. 12 datë 02.07.2020 të BMP-së *“Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”*, që shërben si udhëzues për matjen e riskut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, BMP ka miratuar një plan inspektimi, që është kryer përkatësisht, 4 në muajt nëntor–dhjetor 2020 dhe 4 në muajt janar–shkurt 2021.
- Gjatë kësaj periudhe, me mbështetjen e Bankës Botërore, BMP ka rishikuar dhe përmirësuar kuadrin rregullator të provimeve për kandidatët për auditues ligjor dhe kontabilist i miratuar, përkatësisht rregulloren Nr. 2 datë 22.02.2018 *“Për funksionimin e komisionit të provimeve të aftësive profesionale dhe mbikëqyrjes së procesit të testimit të kandidatëve për auditues ligjor dhe kontabilist të miratuar”*, e ndryshuar dhe rregulloren nr.6, datë 31.05.2018 *“Për procedurat e testimit dhe sistemin e vlerësimit në provimin e aftësive profesionale të kandidatëve për auditues ligjor dhe kontabilist i miratuar”*.

Gjatë periudhave të fundit, janë realizuar katër kontrolle të kufizuara për audituesit ligjorë me më pak se 5 vite eksperiencë, ku janë rishikuar 4 dosje angazhimi auditimi. Gjatë muajit gusht 2021, Bordi i Mbikëqyrjes Publike, ka realizuar njoftimin e inspektimit të kontrollit të



cilësisë në 13 subjekte auditues ligjorë/shoqëri auditimi në përputhje me kalendarin vjetor të punës për inspektimet e kontrollit të sigurimit të cilësisë. Gjatë muajit shtator është realizuar dorëzimi i informacionit të kërkuar për realizimin e procesit të kontrollit të cilësisë dhe gjatë muajve tetor–dhjetor 2021.

BMP do të vijojë realizimin e veprimtarisë së vet bazuar në referencat e KE, me fokus të veçantë kontrollin e cilësisë ndaj auditimeve të njësive ekonomike me interes publik, si dhe marrjen e masave disiplinore në rastet përkatëse.



PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Legjislacioni tregtar mbetet një nga fushat më të rëndësishme të ligjit të BE. Megjithatë, mbetet një sfidë për të përmbushur të gjitha kërkesat e acquis për shkak të rritjes së vëllimit të acquis në këtë fushë, si dhe ndryshimet e përhershme ligjore. Edhe pse disa pjesë të ligjit shqiptar mund të jetë në pajtueshmëri të plotë, ka fusha të tjera ku rishikimi më tej është i nevojshëm, sidomos në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, kryesisht në forcimin e kapaciteteve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

- Ne ende ndodhemi në proces e sipër përse i përket përafrimit të legjislacionit tregtar shqiptar me atë të standarteve Evropiane, prandaj vëndi ynë edhe në vitet që pasojnë duhet të vazhdojë përpjekjet për tu integruar. Kjo arrihet në bazë të prioriteteve që ne do ti vendosim çështjeve të caktuara. Duke qënë se kemi të bëjmë me një plan për të ardhmen është e nevojshme përgatitja e një rezymeje se ku do të vendoset fokusi. Në bazë të raporteve të dhëna Shqipëria do të vendos fokusin në çështje të cilat unë i kam cekur gjatë gjithë punimit.
- Duhet bërë një rishikim të legjislacionit ekzistent në fushën e ligjit për shoqëritë tregtare me qëllim përcaktimin e ndryshimeve që duhet të zhvillohen për të çuar kështu drejt fundit këtë përafrim të legjislacionit tonë tregtar me acquis të BE-së, duke dashur kështu të mbyllim me sukses të gjitha këto ndërhyrje dhe ndryshime të bërë në nene të caktuara të ligjit tonë.
- Gjithashtu, një fokus edhe më i madh kërkohet në përafrimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor për kontabilitetin dhe auditimin me acquis më të fundit të BE-së në këto fusha. Nevoja për përmirësime në këtë fushë është cekur edhe më sipër teksa ceknim ndryshimet e bëra.
- Më tej në varësi dhe të raporteve të Komisionit Evropian dhe rekomandimeve të tij për prioritetet në vitet e ardhshme fokusi duhet vendoset edhe në përmirësimin e funksioneve dhe kapaciteteve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike (BMP) dhe harmonizimi me rregullat e auditimit ligjor të BE.
- Një pjesë tjetër ku do të ndalesha është edhe mos marrja e mjaftueshme e masave kundër pastrimit të parave në Shqipëri, e cila është një nga kërkesat që Bordi



Mbikëqyrës duhet të përmbush.

- Edhe përsa i përket fushës së Auditimit Ligji Nr.10091 datë 5.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar përpjekjet për një përputhje me kërkesat e vendosura nga direktiva janë të mëdha, por ende nuk ka një përputhje të plotë me Direktivën dhe Rregulloren siç është ajo e pavarësisë së audituesit.

Së fundmi vlen të theksojmë që të gjitha këto rekomandime të lartpërmendura nuk do të përmirësohen në një kohë afatshkurtër, por në një periudhë kohore të caktuar besoj që do të vijin përmirësime të njëpasnjëshme duke arritur përfundimisht në synimin tonë për tu anëtarësuar në Bashkimin Evropian. Kjo gjithmonë duke u bazuar në raportet e nxjerra dhe marrja parasysh e mangësive që u vendosen në dukje dhe të rregullojnë boshllëqet ose mospërputhjet që u kërkohen.



BIBLIOGRAFI

- <https://gostivar.eregulations.org/media/Ligji%20per%20shoqerite%20tregtare.pdf>
- https://www.parlament.al/Files/Integrimi/ligj_nr_129_dt_2_10_2014_19391_12.pdf
- https://www.mei-ks.net/repository/docs/Direktive_200556KE_e_Parlamentit_Europian_dhe_Keshillit,_date_26_tetor_2005,_per_bashkimin_nderkufitar_te_shoqerive_tregtare_me_p.pdf
- <https://financa.gov.al/standartet-kombetare-te-kontabilitetit/>
- <https://www.dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/61-marreveshja-e-stabilizim-asociimit>
- <http://www.instat.gov.al/al/integrimi/historiku/>
- <http://integrimi-ne-be.puneteshtme.gov.al/wp-content/uploads/2020/04/3.-Urdher-i-KM-no.113-dt.30.08.2019-PPIE.pdf>
- <https://european-union.europa.eu/select-language?destination=/node/1>

